



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 42, datë 09.07.2026

PËR MIRATIMIN E LISTAVE SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË PALLATIN KASTRATI NR. 14, RRUGA “STEFAN DHIMA”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; PALLATIN NR. 8, RRUGA “STEFAN DHIMA”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 3; PALLATIN NR. 25/1, RRUGA “HYSEN MYSHKETA”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 3; PALLATIN NR. 18, RRUGA “DAVID SELENICA”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; PALLATIN NR. 52, RRUGA “SELVIA”, NJËSIA ADMINISTRATIVE SUKTH; MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NR. RENDOR 1 TË ANEKSIT NR. 1 “SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 2” TË VKB-SË NR. 79, DATË 29.07.2024, SI DHE MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NR. RENDOR 1 TË ANEKSIT NR. 3 “SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 5” TË VKB-SË NR. 86, DATË 31.08.2020.

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 08.01.2020, “Për përcaktimin e procedurave për përfitimin nga programi i granteve të rindërtimit”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr. 164, datë 26.05.2020, “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, dhe Urdhrit nr.234, datë 18.08.2025, “Për riformatimin e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit”, si dhe procedurës së ndjekur nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, si dhe sipas relacionit të për gatitur nga Komisioni i Posaçëm i Rindërtimit, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**



1. Për miratimin e listave së përfituesve nga Programi i Procesit të Rindërtimit në pallatet si më poshtë:
 - a. Miratimi i listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin Kastrati, nr.14, rruga “Stefan Dhima”, njësi administrative nr.5, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, sipas Aneksit 1.
 - b. Miratimi i listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për Nr. 8 rruga “Stefan Dhima” njësi administrative nr. 3, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, sipas Aneksit 2.
 - c. Miratimi i listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin Nr. 25/1 rruga “Hysen Myshketa” njësi administrative nr. 3, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, sipas Aneksit 3.
 - d. Miratimi i listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin Nr. 18 rruga “David Selenica” njësi administrative nr. 5, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, sipas Aneksit 4.
 - e. Miratimi i listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin Nr.52, rruga “Selvia”, njësi administrative Sukth, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, sipas Aneksit 5.
2. Për miratimin e ndryshimit të nr.rendor 1 të Ankesit nr.1 “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në njësinë administrative nr.2” të VKB-së nr.79 datë 29.07.2024, sipas Aneksit 6.
3. Për miratimin e ndryshimit të nr.rendor 1 të Ankesit nr.3 “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në njësinë administrative nr.5” të VKB-së nr.86 datë 31.08.2020, sipas Aneksit 7.
4. Aneksat nr. 1–7 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, si dhe Komisioni i Posaçëm.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARE
Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 10.07.2026

Aneksi 1 “Lista e përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin Kastrati nr.14, rruga “Stefan Dhima”, njësia administrative nr.5.

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHE	Programi
1	Stefan Selimi, Qyqe Selimi	5	3+1	
2	Fation Shkoza, Edlira Vranoci, Marina Vranoci, Erjona Vranoci	1	1+1	

Aneksi 2 “Lista e përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin Nr. 8 rruga “Stefan Dhima” njësia administrative nr. 3.

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHE	Programi
1	Agron Imaj, Shpresa Imaj	4	2+1	Zona e Re për Zhvillim Spitallë
2	Artur Celami, Florida Celami	3	2+1	Zona e Re për Zhvillim Spitallë
3	Dritan Çopa	1	1+1	Zona e Re për Zhvillim Spitallë

Aneksi 3 “Lista e përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin Nr. 25/1 rruga “Hysen Myshketa” njësia administrative nr. 3.

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHE	Programi
1	Kastriot Zotaj, Natasha Zotaj	3	2+1	Zona e Re për Zhvillim Spitallë

Aneksi 4 “Lista e përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin Nr. 18 rruga “David Selenica” njësia administrative nr. 5.

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHE	Programi
1	Majlinda Theodhori	4	2+1	Zona e Re për Zhvillim Spitallë



Aneksi 5 “Lista e përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr.52, rruga “Selvia” njësia administrative Sukth.

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET	Programi
1	Kujtim Arapi	3	2+1	Zona e Re për Zhvillim Spitalë

Aneksi 6 “Për miratimin e ndryshimit të nr.rendor 1 të ankesit nr.1 “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në njësinë administrative nr.2” të VKB-së nr.79 datë 29.07.2024

NR	NJESIA ADMINISTRATIVE	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	VKB FITUESE	PËRBËRJA FAMILJARE	STRUKTURA E BANESËS	VLERA E GRANTIT
1	R2	NURIE	FUAT	NALLBANI	NR. 79 DATE 29.07.2024	1	1+1	2,236,552

Aneksi 7 “Për miratimin e ndryshimit të nr.rendor 1 të ankesit nr.3 “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në njësinë administrative nr.5” të VKB-së nr.86 datë 31.08.2020

NR	NJESIA ADMINISTRATIVE	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	VKB FITUESE	PËRBËRJA FAMILJARE	STRUKTURA E BANESËS	VLERA E GRANTIT
1	R5	VIKTOR	VEXHI	SHEQI	NR. 86 DATE 31.08.2020	4	2+1	2,617,558



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës


Nr. 537/18 prot.

Durrës, më 15 . 07 .2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.42 datë 09.07.2026, “Për miratimin e listave së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Pallatin Kastrati nr. 14, rruga “Stefan Dhima”, Njësia Administrative nr. 5; Pallatin nr. 8, rruga “Stefan Dhima”, Njësia Administrative nr. 3; Pallatin nr. 25/1, rruga “Hysen Myshketa”, Njësia Administrative nr. 3; Pallatin nr. 18, rruga “David Selenica”, Njësia Administrative nr. 5; Pallatin nr. 52, rruga “Selvia”, Njësia Administrative Sukth; Miratimin e ndryshimit të nr. rendor 1 të aneksit nr. 1 “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative nr. 2” të vkb-së nr. 79, datë 29.07.2024, si dhe miratimin e ndryshimit të nr. rendor 1 të aneksit nr. 3 “Subjektet përfituese nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative nr. 5” të vkb-së nr. 86, datë 31.08.2020”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi e Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) i ndryshuar “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karkater individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
ADRIAN GURRA

